

KPK konfirmon në detyrë kryetarin e Gjykatës së Tiranës Petrit Çomo

6 Gusht 2020 LAJME,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit konfirmoi sot në detyrë kryetarin e Gjykatës së Tiranës, Petrit Çomo. Ai iu nënshtrua procesit të vetingut për tri kriteret, ligjshmërinë e pasurisë, pastërtinë e figurës dhe profesionalizmin.

Petrit Çomo e ka filluar karrierën në sistemin e drejtësisë në vitin 2000 ndërsa në vitin 2015, ai u zgjodh anëtar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë –detyrë të cilën e mbajti deri në shkërrjen e këtij institucioni. Çomo vjen nga radhët e ish të përndjekurve politikë në Shqipëri. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka evidentuar faktin që ai është djali i Liri Belishovës dhe Maqo Çomos, dy ish zyrtarë të lartë të pushtetit komunist. Ata kanë qenë përkatësisht anëtare e Byrosë Politike dhe e Komitetit Qendror të PPSH-së, dhe komisar i Brigadës së 15-të, zv/ministër dhe ministër.